

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 2-2021

Shtatëzënia e komplikuar me PIH Syndromë, komplikimet amtare dhe fetale

Vjollca Bytyqi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Nursing Commons](#)

Recommended Citation

Bytyqi, Vjollca, "Shtatëzënia e komplikuar me PIH Syndromë, komplikimet amtare dhe fetale" (2021). *Theses and Dissertations*. 2234.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2234>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT

Fakulteti Infermierisë

Shtatëzënia e komplikuar me PIH Syndromë, komplikimet amtare dhe fetale

Shkalla Bachelor

Vjollca Bytyqi

Shkurt/ 2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Infermierisë

Punim Diplome

2017/2018

Vjollca Bytyqi

Shtatëzënia e komplikuar me PIH syndromë, komplikimet amtare dhe fetale

Mentori: Dr. Sc. Hana Bejiqi

Shkurt/ 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme
për Shkallë Bachelor

ABSTRAKT

Hyrje: Hipertensioni i shkaktuar nga shtatëzënia (pregnancy induced hypertension- PIH) ndërlikon 6-10% të shtatëzënive. Përkufizohet si presion sistolik i gjakut > 140 mmHg dhe presion diastolik i gjakut > 90 mmHg. Klasifikohet si i butë (PSGJ 140-149 dhe PDGJ 90-99 mmHg), i moderuar (PSGJ 150-159 dhe PSGJ 100-109 mmHg) dhe i rëndë (PSGJ \geq 160 dhe PDGJ \geq 110 mmHg). PIH syndroma është një nga shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe fetale. Gratë me PIH syndromë janë të rrezikuara nga rreziku i madh për; abruption të placentës, (shkollitje e parakoheshme e placentes, shkollitja e placentes nga java e 21+), ngjarjeve cerebrovaskulare (insult cerebrovaskular – ICV), aneurizem të eneve të gjakut në tru, dështimit të organeve hematopoetike dhe koagulimit intravaskular të shpërndarë – DIK. Fetuset nga këto shtatëzëni janë në rrezik më të madh të ngadalësimit të rritjes intrauterine IUGR, prematuritetit dhe vdekjes intrauterine.

Ky punim është realizuar me qëllim të zgjerimit të njohurive të infermierëve të ardhshëm në fushën e Gjinekologjisë, respektivisht kujdesit infermior tek gratë shtatëzëna me çrregullime hipertensive.

Metodologjia: Ky studim është retrospektiv ku janë përfshirë gratë shtatëzëna me çrregullime hipertensive, përkatsisht me preeklampsi, eklampsi dhe hellp syndromë të shtruar dhe të trajtuara në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, QKUK Prishtinë, gjatë periudhës kohore 2019-2020. Të dhënat në punim janë marrë nga protokollet e pacientëve të Klinikës Obstetrike Gjinekologjike.

Rezultatet: Në periudhën kohore 2019-2020 nga 162 paciente të prekura me hipertension gjatë shtatëzënisë, 101 paciente kanë qenë vetëm me hipertension, 50 paciente kanë qenë me preeklampsi, 2 paciente kanë qenë me eklampsi dhe 9 paciente me hellp syndromë.

Përfundimi: Përmes këtij punimi kemi arritur të pasqyrojmë dhe vleresojmë rëndësinë e rolit të infermieres në kujdesin ndaj pacienteve me hipertension gjatë shtatëzënisë, të hulumtojmë më shumë rreth komplikimeve dhe rreziqeve nga hipertensioni siq janë; shkaktaret e sëmundjes, shenjat e sëmundjes, diagnostifikimi, parandalimi, kujdesi infermior të gratë shtatëzëna me hipertension dhe numri i grave që rrezikohen nga kjo sëmundje gjatë shtatëzënisë.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Fillimisht dua ta falënderoj familjen time për mbështetjen dhe kurajon e vazhdueshme gjatë studimeve.

Falënderoj të gjithë profesoret dhe stafin akademik të UBT-së.

Falënderoj Dr. Sc. Hana Bejiqi për mbështetjen e vazhdueshme gjatë punimit të këtij punimi, për punën e palodhshme, për durimin, korrektësin dhe këshillat që më ofroi gjatë kësaj kohe.

PERMBAJTJA	
FJALORI I TERMAVE	8
1 HYRJE	9
1.1 Klasifikimi hipertensionit gjatë shtatëzënisë	9
1.2 Simptomat e hipertensionit në shtatëzëni	11
1.3 Diagnoza e hipertensionit	12
1.4 Si ndikon hipertensioni në shtatëzëni	14
1.5 Kush është në rrezik më të lartë të shfaqjes së hipertensionit gjatë shtatëzënisë	15
2. SHQYRTIMI I LITERATURES	16
2.1 Pre-eklampsia	16
2.1.1 Patofiziologjia e preeklampsisë	18
2.1.2 Shenjat dhe simptomat e preeklampsisë	19
2.1.3 Diagnostikimi i preeklampsisë	20
2.1.4 Çfarë mund të ndodh me nënën?	21
2.1.5 Çfarë mund të ndodh tek fetusi	22
2.1.6 Faktorët predispozues të preeklampsisë	22
2.1.7 Menaxhimi i preeklampsisë	22
2.1.8 Parandalimi i preeklampsisë	23
2.2 Eklampsia	24
2.2.1 Çfarë e shkakton eklampsinë?	24
2.2.2 Simptomat e eklampsisë?	25
2.2.3 Diagnostikimi i eklampsisë	26
2.2.4 Komplikimet te nëna dhe te fetusi	27
2.2.5 Parandalimi i eklampsisë	29

2.3 Syndroma HELLP	29
2.3.1 Simptomat e syndromes HELLP	30
2.3.2 Diagnostifikimi i syndromes HELLP	31
2.3.3 Syndroma HELLP tek nëna dhe fetusi	31
2.3.4 Trajtimi i syndromës HELLP	32
2.3.5 Parandalimi i syndromës HELLP:	33
2.5 Menaxhimi i infermierorë	33
2.5.1 Vlerësimi i infermierisë	34
2.5.2 Ndërhyrjet infermierore	34
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	35
4 METODOLGJIA	36
5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	37
6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	42
7. REFERENCAT	43
8. SHTOJCAT	45

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Matja e presionit të gjakut nga infermierja	12
Figura 2. Simptomat e eklampsisë	26
Figura 3. Mënyrat e lindjes të shtatzënave me sëmundje hipertensive	37
Figura 4. Sëmundjet hipertensive në relacion me grup moshën e nënës	39
Figura 5. Struktura e sëmundjeve hipertensive në shtatzëni	41

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Karakteristikat e llojeve të hipertensionit dhe pre-eklampsisë	17
Tabela 2. Paraqitja tabelare e numrit të lindjeve me sëmundje hipertensive për vitin 2019-2020	37
Tabela 3. Struktura e shtazënave sipas grup moshës	38
Tabela 4. Struktura e shtatzënave sipas llojit të hipertensionit	40

FJALORI I TERMAVE

(PIH syndrom) – shtatëzania e komplikuar me hipertension

(TA) –Tensionsioni arterial

(HTA) –Hipertensionioni arterial

(PE) – Preeklampsia

(HELLP Syndrom) –hemoliza, rritja e nivelit të enzimave hepatike në gjak dhe trombocitopenia

(PGJ) – Presioni i gjakut

(PSGJ) – Presioni sistolik i gjakut

(PDGJ) –Presioni diastolik i gjakut

(ALT) –Alaninë - transaminaza

(AST) –Aspartat – transaminaza

(PPT) –Purpura trombotike trombocitopenike

(IURG) – Kufizimi i rritjes intra uterine

(TJS) –Testimi jo stresues

(MRI) – Imazheria e rezonancës magnetike

(DIK) – Koagulimi intravaskular i diseminuar

(SDRA) –Sindroma e distresit respirator të rriturit

(IV)–Intravenoz

1 HYRJE

Presioni i gjakut është forca me të cilën zemra shtyen gjakun kunder forcës së mureve të gjakut. Zemra pompon gjak në arteriet (enët e gjakut) që bartin gjakun në të gjithë trupin. Presioni i lartë i gjakut, i quajtur ndryshe hipertension, do të thotë që presioni në arterie është mbi vlerat 140/90 mmHg (1).

Hipertensioni i shkaktuar nga shtatëzënia (PIH syndromë) është një gjendje ku vazospazma ndodh gjatë shtatëzënisë në arteriet e vogla dhe të mëdha në trup. Te presioni i lartë i gjakut regjistrohet rritje e rezistencës së enëve të gjakut. Kjo pengon qarkullimin laminar të gjakut në shumë organe dhe sisteme të organeve tek nëna në barrë duke përfshirë çregullimin e rrjedhjes normale të gjakut në mëlçi, veshka, organin truror, mitër dhe placentë -uren lidhese mes nënës dhe frytit. **Është shumë me rëndësi të kuptohet se hipertensioni në shtatëzëni zanafillen e ka në ngjitjet patologjike të placentes në miter.** Njihet gjithashtu si hipertensioni gjestacional.

Hipertensioni i Shkaktuar nga Shtatëzënia (PIH syndromë) është një formë e presionit të lartë të gjakut në shtatëzëni që ndërlikon 6-10% të shtatëzënive dhe përben shkakun madhor të sëmundshmërisë amtare dhe fetale(2).

1.1 Klasifikimi i hipertensionit gjatë shtatëzënisë

Çrregullimet e hipertensionit gjatë shtatëzënisë klasifikohen në 4 kategori: 1) hipertension kronik, 2) preeklampsi-eklampsi, 3) preeklampsi e mbivendosur në hipertension kronik dhe 4) hipertensioni gjestacional (hipertensioni kalimtar i shtatëzënisë ose hipertensioni kronik i identifikuar në gjysmën e fundit të shtatëzënisë). Hipertension i shkaktuar nga shtatëzënia (PIH-syndroma) preferohet mbi termin më të vjetër, por të përdorur gjerësisht, EPH-gestoza sepse është më i saktë.

- **Hipertensioni kronik;** Hipertensioni kronik është presion i lartë i gjakut që: ose i paraprin shtatëzënisë, ose shfaqet para javës së 20 të shtatëzënisë. Njihen dy kategori të hipertensionit: e lehtë (deri në 179 mmHg sistolike dhe 109 mmHg diastolike) dhe e rëndë (\geq 180 mmHg sistolike ose 110 mmHg diastolike). Hipertensioni kronik ndërlikon

rreth 5% të të gjitha shtatëzënive. Por edhe hipertensioni që vazhdon më shumë se 42 ditë pas lindjes, klasifikohet si hipertensioni kronik.

Mund të jetë parësor-esencial, dhe dytësor-i superponuar, në terren të patologjive të tjera si: sëmundjet renale, diabeti, Lupusi etj.

Inçidenca e HTA kronik varion midis popullatave të ndryshme duke shkuar nga 0.5-4% të rasteve dhe mesatarja është 2.5 %. Hipertensioni kronik në shtatëzëni zakonisht është idiopatik (80 % të rasteve) ose nga sëmundjet renale (20 % të rasteve). Shumica e shenjave klinike, te shtatëzënat me hipertension kronik, lajmerohen në moshën mbi 30 vjeç te multiparet me probleme mjekësore shoqëruese si: diabeti ose sëmundjet renale. Inçidenca është më e lartë në gratë e racës së zezë dhe në gratë me histori familjare për hipertension. Një grua që ka lindur një apo disa fëmijë dhe ka hipertension në shtatëzëni, ka të ngjarë të ketë hipertension kronik (3, 17).

- **Hipertensioni kronik me preeklampsi të mbivendosur;** Kjo gjendje shfaqet te gratë që janë diagnostikuar me presion të lartë kronik të gjakut përpara shtatëzënisë, por më pas komplikohet me rritje të metutjeshme të presionit të gjakut dhe lajmerim të proteinave në urinë. Pasojë e hipertensionit kronik te gratë është preeklampsia, e cila rritë sëmundshmërinë e nënës dhe fetusit. Diagnostikimi i preeklampsisë që i mbivendoset hipertensionit kronik bazohet në një ose më shumë shenja të më poshtme: shtimi në peshë i cili nganjeherë mund të jetë 0.5-1kg në javë (për shkak të rritjes së sasisë së lëngut ekstracelular dhe retences së Na); edemat në ekstremitetet e poshtme, të cilat çdo ditë rriten, duke përfshirë: shputat, nën gjurin, e më vonë edhe barkun dhe fytyrën; fillimi i proteinurisë, që përcaktohet si sekretimi në urinë i 0.5 g proteinash ose më shumë gjatë 24 orëve; hipertensioni, i cili mund të jetë i moderuar: 160/110mmHg ose i rëndë deri 200/140mmHg dhe paraqet rrezik akut për nënën.
- Te gratë me hipertension por pa proteinuri përpara javës së 20-të shtatëzënisë, si dhe ato me hipertension dhe proteinuri gjithashtu për para javës së 20, vendosja e diagnozës kërkon shfaqjen e shenjave të hipertensionit të rëndë, trombocitopeninë dhe rritjen e nivelit të enzimave të mëlçisë.

- **-Hipertensioni gjestacional (PIH Syndroma);** Hipertensioni pa proteinuri, që shfaqet mbas javës së 20-të të shtatëzënisë quhet hipertension i shtatëzënisë. Diagnostikohet vetëm gjatë shtatëzënisë. Hipertensioni percaktohet si një PGJ më i lartë ose i barabartë me 140 mmHg sistolike, dhe 90 mmHg diastolike. Rrallë mund të komplikohet me preeklampsi. PGJ normalizohet pas javës së 12-të shtatëzënisë. Mund të përsëritet në shtatëzënitë e ardhme dhe është parashikues i HTA esencial në të ardhmen. Kur ky hipertension përsiston edhe 12-të javë pas lindjes, atëherë duhet të konsiderohet si hipertension arterial kronik (17).
- **-Preeklampsia:** është një formë hipertensioni, i cili është përcaktuar si hipertension i shtatëzënisë pas 20 javësh plus proteinuria. Gjetja klinike e preeklampsisë mund të manifestohet: ose si sindromë e nënës (hipertension dhe proteinuri me ose pa anomali të tjera multisistemike), ose si një sindromë fetale (kufizime në rritjen e fetusit, zvogëlim të lëngut aminiotik dhe oksigjenim jonormal). -Syndroma e preeklampsisë së nënës përfaqëson një shtrirje klinike me ndryshime të mëdha, ndërmjet preeklampsisë në fund të shtatëzënisë pa ndërlikime të fetusit, kundrejt preeklampsisë që lidhet me peshë të ulët lindjeje dhe lindje të parakohshme (17).

1.2 Simptomat e hipertensionit në shtatëzëni

Simptomat mund të përfshijnë:

- Rritja e presionit të gjakut,
- Mungesa ose prania e proteinave në urinë (për të diagnostikuar hipertensionin gjestacional ose preeklampsinë),
- Edemë (ënjtje),
- Shtim i papritur i peshës,
- Ndryshimet vizuale të tilla si vizioni i paqartë ose i dyfishtë,
- Të përziera, të vjella,
- Dhimbje të barkut të sipërm të anës së djathtë ose dhimbje rreth stomakut,
- Urinimi i sasive të vogla të urinës,

- Ndryshimet në testet funksionale të mëlçisë ose veshkave (4).

1.3 Diagnoza e hipertensionit

Diagnoza e hipertensionit duhet mbështetur në matjet e shtypjes së gjakut në ambulancë apo në spital. Hipertensioni në shtatëzëni duhet definuar si shtypje sistolike e gjakut prej ≥ 140 mmHg dhe / apo shtypja diastolike e gjakut prej ≥ 90 mmHg, bazuar në mesataren prej të paktën dy matjeve, të kryera 15 minuta ndaras nga njëra tjetra, me përdorimin e të njëjtës dorë.

Ne studimin tonë duhet të kemi parasysh se objekt kemi paciente shtatëzëne dhe duhet ta japim diagnozen infermirore sa më të saktë: nëse kemi të bëjmë me hipertension kronik ose hipertension në shtatëzani (duke u bazuar ne moshen gjestative).



Figura 1. Matja e presionit të gjakut nga infermierja

(Huazuar nga; <https://parenting.firstcry.com/>)

Infermieret gjithashtu kanë një rol në uljen e presionit të gjakut të pacientet me hipertension gjatë shtatëzënisë. Në figurën 1. Shihet mënyra e matjes së presionit të gjakut nga infermierja për të vlerësuar PGJ në shtatëzëni. Kjo na ndihmon në diagnostikimin e çrregullimeve si pasojë e

hipertensionit në shtatëzëni vlerësimin e cilësisë së jetës së grave në shtatëzëni me hipertensionin dhe ecurinë e metutjeshme të shtatëzënisë.

Menyra e matjes së gjakut;

- Zhvishni rrobat e ngushta,
- Sigurohuni që pacientja të jetë e relaksuar gjatë matjes së presionit të gjakut,
- Matja mund të bëhet në të dy duart, dora të jetë e mbështetur në nivel të zemrës,
- Përdorni manzhetën e madhësisë së përshtatshme,
- Fryni manzhetën deri 20-30 mmHg mbi shtypjen sistolike të gjakut të palpuar,
- Shfryni manzhetën ngadalë nga 2 mmHg në sekondë apo në çdo rrahje puls,
- Regjistroni shtypjen diastolike të gjakut si zhdukje të tingullit,
- Nëse shtypja e gjakut është vazhdimisht më e lartë në njërin dorë, duhet të përdoret dora me vlera më të larta për të gjitha matjet e metutjeshme të PGJ (5, 17)

Vlersimi i proteinurisë;

- Testi i zhytjes së shiritit në urinë mund të përdoret për të kontrolluar proteinurinë.
- Nëse shiriti tregon se proteinuria është $\geq 1+$ apo në çfarëdo rasti të dyshimit të lartë klinik, kërkoni proteinat e njollës urinare: grumbullimi 24 orësh i urinës për të matur (kuantifikuar) proteinurinë;
- Proteinuria tregon për dëmtim glomerular dhe pothuajse gjithmonë ndodh pas hipertensionit.
- Proteinuria zakonisht është në intervalin prej 1-3 g në ditë, nga e cila 50-60% është albuminuri, por në raste të rënda mund të jenë edhe fraksionet tjera të proteinave.

Edema

- Vetëm edema e papritur dhe/ apo e gjeneralizuar duhet të vlerësohet për diagnozën e preeklampsisë,

- Edema e duarve dhe nyjeve të këmbëve shpesh janë reagime fiziologjike normale (50-80 %) në një qarkullim të rritur dhe shtim peshë në shtatëzëni (18,6).

1.4 Si ndikon hipertensioni në shtatëzëni?

Presioni i lartë i gjakut gjatë shtatëzënisë mund të shkaktojë probleme serioze, përfshirë problemet e rritjes së fetusit, lindjen e parakohshme dhe përkeqësimin e kushteve para-ekzistuese si shkak i presionit të lartë të gjakut. Presioni i lartë i gjakut gjatë shtatëzënisë mund të ndikojë në zhvillimin e placentës, duke bërë që furnizimi me materie ushqyese dhe oksigjen, për foshnjën të jetë i kufizuar. Kjo mund të çojë në lindje të parakohshme, peshë të ulët të fetusit në lindje, ndarje placentare (shkëputje) dhe komplikime tjera për foshnjën.

Presioni i lartë i gjakut gjatë shtatëzënisë mund të ndikojë në organizem në mënyra të ndryshme. Nënmat me presion të lartë të gjakut gjatë shtatëzënisë janë në një rrezik më të lartë të komplikimeve para, gjatë dhe pas lindjes. Jo vetëm që shëndeti i nënës është në rrezik, por edhe foshnja mund të ndikohet nga presioni i lartë i gjakut gjatë shtatëzënisë.

Presioni i lartë i gjakut mund të ndikojë në enët e gjakut që të zvogëlojë rrjedhjen e gjakut në: mëlçi, veshke, mitër dhe placentë.

Kjo gjendje mund të përkeqësohet dhe të çojë në preeklampsi dhe eklampsi. Ose të shkaktojë probleme serioze si në vijim;

- Shkëputje e parakohshme e placentës (ndodh kur placenta ndahet nga mitra shumë herët),
- Rritja e pamjaftueshme e fetusit –ngecja intrauterine e rritjes, (IUGR)
- Konvulsionet (eklampsia),
- Vdekja e nënës dhe fetusit,

1.5 Kush është në rrezik më të lartë të shfaqjes së hipertensionit gjatë shtatëzënisë?

Një grua ka më shumë të ngjarë të zhvillojë hipertension gjatë shtatëzënisë nëse:

- Është nën moshën 20 vjeç ose mbi 40 vjeç,
- Ka një histori të hipertensionit kronik (presion i lartë i gjakut para se të mbetet shtatëzënë),
- Ka pasur hipertension gjestacional ose preeklampsi gjatë shtatëzënieve paraprake,
- Ka një histori familjare të hipertensionit gjestacional,
- Ka diabet ose diabet gjestacional,
- Ka mbipeshë,
- Ka një çrregullim të sistemit imunitar ose sëmundje autoimune, siç është lupusi;
- Ka sëmundje të veshkave,
- Ka shtatëzëni të shumëfishta, (1)

2. SHQYRTIMI I LITERATURES

2.1 Preeklampsia

Preeklampsia është një formë hipertensioni, i cili është përcaktuar si hipertension i shtatëzënisë i shoqëruar me proteinuri. Gjetjet klinike të preeklampsia mund të manifestohen ose si sindromë e nënës ose si një sindromë fetale.

Preeklampsia po bëhet një diagnozë gjithnjë e më e zakonshme në vendet e zhvilluar dhe mbetet një shkak i lartë i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënës dhe frytit, në vendet në zhvillim. Vonesa në lindjen e fetusit në vendet e zhvilluara, bazohet në faktorët e rrezikut të shoqëruar me preeklampsi, të cilët përfshijnë moshën më të vjetër të nënës, mbipeshen dhe / ose sëmundjet vasculare.

Sëmundja paraqet hipertension primar dhe shpesh proteinurinë e nënës, e cila mund të përparojë në mosfunksionim multi-organik, duke përfshirë sëmundjen hepatike, renale dhe cerebrale, nëse fetusi dhe placenta mbijetojnë. Mosfunksionimi endotelial i nënës për shkak të faktorëve qarkullues të origjinës fetale nga placenta është një shenjë dalluese e paraklampsisë.

Presioni i lartë i gjakut gjatë shtatëzënisë mund të çojë në ulje të rrjedhjes së gjakut në placentë, prishje të placentës, lindje të parakohshme ose sëmundje të ardhshme kardiovaskulare.

Pas lindjes së fëmijës, presioni i lartë i gjakut që ishte prezent gjatë shtatëzënisë, zakonisht kthehet në nivel normal (17).

Tabela 1. Karakteristikat e llojeve të hipertensionit dhe pre-eklampsisë

Lloji	Presion i lartë i gjakut (matur dy herë, me 6 orë diference)	Proteinuria	Simptomat e ashpërsisë
Hipertensioni gjestacional (zhvillohet gjatë shtatëzënësisë)	Mbi 140/90 mmHg	Nuk ka proteinuri të rëndësishme	Asnjë
Preeklampsia e lehtë	Ndërmjet 140/90 dhe 160/110 mmHg	Nuk ka proteinuri të rëndësishme	Asnjë
Preeklampsia e rëndë	Më e madhe se ose e barabartë me 160/110 mmHg	Me ose pa proteinuri domethënëse (rezultati i provës së pikës së urinës më i madh ose i barabartë me +2)	Dhimbje koke, vizion të paqartë, dhimbje djegieje epigastrike, ulje të daljes së urinës, ulje ose mungim të goditjes fetale
Pre-eklampsia e mbivendosur	Më e lartë se para shtatëzënës në një grua të njohur hipertensive kronike	Proteinuria e rëndësishme ose përkeqësuese	Me ose pa simptoma të ashpërsisë

2.1.1 Patofiziologjia e preeklampsisë

Preeklampsia mund të përfaqësojë më shumë se një gjendje të vetme ose të përfshijë nëntipe të sëmundjes me shkaqe të ndryshme dhe paraqitje klinike. Gjetjet klinike sugjerojnë që patogjeneza e preeklampsisë vazhdon në faza:

Faza e hershme ndodh gjatë javës 8 deri 18 të shtatëzënisë dhe përfshin zhvillim të ndryshuar të placentës që zvogëlon rrjedhën e gjakut, midis qarkullimit të nënës dhe fetusit. Në këtë fazë të hershme nuk mund të diagnostikohen shenjat apo simptomat klinike. Shenjat dhe simptomat e preeklampsisë nuk shfaqen deri në gjysmën e dytë të shtatëzënisë, megjithëse ato janë sekondare ndaj perfuzionit të dëmtuar të placentës që ndodh në javët e para të shtatëzënisë.

Roli i placentës në qarkullimin nënë – fetus: Placenta siguron materie kryesor të ushqimit për fetusin në rritje gjatë shtatëzënisë, duke i dhënë materie ushqyese të nevojshme dhe oksigjen. Dy faktorë janë kritikë në këtë proces shkëmbimi: shpërndarja e qarkullimit të nënës në placentë dhe sipërfaqja adekuate e placentës për një shkëmbim të substancave midis qarkullimit të nënës dhe fetusit. Qarkullimi i nënës sjellë materie thelbësore për ushqimin e fetusit përmes arterieve spirale në placentë.

Për të përmbushur nevojat e fetusit deri sa rritet, arteriet spirale të mitrës së nënës duhet t'i nënshtrihen një transformimi që i lejon ata të perfuzojnë placentën në mënyrë efektive gjatë gjithë shtatëzënisë. Transformimi i arterieve spirale të nënës vendoset gjatë zhvillimit të placentës në javët e para të shtatëzënisë. Në preeklampsi, ky transformim është i dëmtuar, gjë që rezulton me një reduktim placentar. Përfuzioni që shkakton një reagim inflamator, rezulton me lirim të citokinave proinflamator dhe krijimin e një balancimi në mes të faktorëve proangiogjenik dhe atyre antiangiogjenike.

Në gjysmën e dytë të shtatëzënisë, ky proces inflamator shfaq shenja dhe simptoma që formojnë bazën për diagnozën e preeklampsisë. Rreshtimi endotelial i enëve të gjakut gjatë qarkullimit të gjakut të nënës është i dëmtuar, duke shkaktuar shtrëngim vazo sistemik dhe hipertension. Endoteli i dëmtuar rritë gjasat e formimit të mpiksjes në vendet e dëmtimit të endotelit. Produktet e mpiksjes konsumohen në formimin e mpiksjes, duke zvogëluar disponueshmërinë e tyre në qarkullimin e nënës dhe duke rritur rrezikun për gjakderdhje. Rritja e përshkueshmërisë vaskulare bënë që lëngu të lëvizë nga kapilarët e nënës në hapësirën intersticiale, duke prodhuar edemë, hemokoncentrim dhe zvogëlim të rrjedhës së gjakut. Edema dhe vazokonstriksioni

dëmtojnë funksionin e mëlçisë, duke zvogëluar disponueshmërinë e albuminës dhe produkteve kryesore të koagulimit. Fluksi i zvogëluar i gjakut renal aktivizon sistemin renin-angiotensin-aldosteron, duke përkeqësuar vazokonstriksionin. Rritja e depërtueshmërisë së kapilarëve glomerular të veshkave lejon që proteina, kryesisht albumina, të kalojë në filtrat glomerular dhe të ekskretohet me urinë (8).

2.1.2 Shenjat dhe simptomat e preeklampsisë

Preeklampsia në stadi fillestar nuk shfaq simptoma. Në këtë stad ajo mund të diagnostikohet nga testet laboratorike. Në shumicën e rasteve kombinimi i hipertensionit me shfaqjen e proteinurisë (proteinat, albuminat në urinë) sugjeron për PE. Megjithatë kjo nuk vlen në të gjitha rastet. Tensioni arterial në preeklampsi zakonisht është mbi vlerat 140/90 mmHg. Një tjetër shenjë (më pak specifike) është edhe edema (enjtja nga grumbullimi i likideve) e këmbëve, duarve dhe fytyrës. Megjithatë edema për shkak se gjindet edhe në një pjesë të mirë të shtatzënive normale nuk mjafton për të dyshuar në preeklampsi (9).

Simptomat e zakonshme të preeklampsisë:

- Presion të lartë të gjakut,
- Ënjtje në fytyrë ose duar,
- Dhimbje koke,
- Shtim i tepërt i peshës,
- Të përzier dhe të vjella,
- Probleme me shikimin, duke përfshirë episode me humbje të shikimit ose vizion të paqartë,
- Vështirësi në urinim,
- Dhimbje barku, veçanërisht në pjesën e sipërme të barkut në të djathtë (9),

2.1.3 Diagnostikimi i preeklampsisë

Preeklampsia përcaktohet si presion i lartë i gjakut pas javës së 20 të shtatëzënisë (≥ 140 mmHg sistolike ose ≥ 90 mmHg diastolike), plus proteinë ($> 0,3$ g / 24 orë). Në praktikën klinike përdorim kriteret e dy matjeve të presionit të lartë të gjakut me distancë prej 6 orësh dhe një proteineuri prej 300 mg në një ekzemplar urine 24-orëshe. Preeklampsia diagnostikohet me rregullin "30-15": presioni sistolik më shumë se 30 mmHg mbi nivelin bazë dhe presioni diastolik më shumë se 15 mmHg mbi nivelin bazë. Sidoqoftë, ky rregull është diskredituar sepse është tepër jospesifik. Në mënyrë të ngjashme, edema e përgjithësuar (që prek fytyrën dhe duart) mund të jetë mbresëlënëse dhe dikur konsiderohet si një kriter diagnostik, por nuk konsiderohet sepse është shumë i ndryshueshëm. Preeklampsia mund të shkojë nga e lehtë në të rëndë. Preeklampsia e rëndë përcaktohet si:

- Matjet e presionit të lartë të gjakut (sistolik ≥ 160 mmHg dhe diastolik ≥ 110 mmHg) të matura të paktën në 6 orë tek pacientet në shtrat,
- Proteinuria (5 g / 24 orë ose + 3+ në dy mostra të rastit me 4 orë),
- Manifestimet e sëmundjes së organeve fundore: oliguria (< 500 ml në 24 orë), çrregullime cerebrale ose vizuale, edemë pulmonare, cianozë, dhimbje epigastrike ose sipërme të djathtë, funksion i dëmtuar i mëlçisë, trombocitopeni ose kufizim i rritjes së fetusit.

Ndryshimet hematologjike përfshijnë:

- Trombocitopenia - trombocitet zvogëlohen në mënyrë dramatike, ndoshta konsumohen nga dëmtimi i endotelit. Numërimet mund të jenë deri në 20 deri $50 \times 10^9 / L$.
- Hemokoncentrimi - mjekët e ndjekin preeklampsinë me analiza serike të hematokritit.
- Hemoliza mikroangiopatike - përfundimisht, qelizat e kuqe gjenden përmes mikroqarkullimit.

Ndryshimet hepatike zakonisht janë të kufizuara në nekrozën hepatoqelizore, të demonstruara nga nivelet e ngritura të alaninës aminotransferazës (**ALT**) dhe aspartat aminotransferazës (**AST**).

Ndonjëherë ka hemorragji subkapsulare dhe madje këputje të mëlçisë, e cila në 60 % të rasteve shkakton vdekshmëri e nënave.

Ndryshimet neurologjike janë të zakonshme dhe përfshijnë: dhimbje koke, vizion të paqartë, skotoma (duke parë njolla ose "dëborë"), hiperrefleksi, rrallë verbëri kortikale dhe kriza të përgjithësuara të eklampsisë.

Ndryshimet renale - Endotelioza glomerulare është dëmtimi patognomonik i preeklampsisë: glomerulat janë të zmadhuar, deformuar dhe mbushur me okluzione, me hipertrofi të qelizave intrakapilare. Testimi laboratorik tregon një ulje të shpejtësisë së filtrimit glomerular, ulje të rrjedhës renale të gjakut (e para më shumë se e dyta) dhe proteineuria joselektive (dmth të gjitha proteinat përfshirë albuminën atë që zbulohen nga testi i zhytjes së shiritit në urinë).

Ndryshimet e fetusit - Perfuzioni i placentës është ulur në preeklampsi, dhe pasojat kryesore janë kufizimi i rritjes intrauterine të fetusit dhe oligohidramnios (është një vëllim i mangët i lëngut aminotik).

Mungesa e oksigjenit dhe lëndëve ushqyese, të cilat mund të dëmtojnë rritjen e fetusit,

Lindja e parakohshme,

Vdekja perinatale lidhet kryesisht me lindjen e parakohshme, shkëputjen e placentës dhe asfiksionin intuterine (10, 17).

2.1.4 Çfarë mund të ndodh me nënën?

Sinjalet, nga pamundësia e placentes për të siguruar një fluks normal gjaku kapen nga enët e gjakut të nënës. Këto enë të gjaku ngushtohen duke bërë që funksioni i veshkave të dëmtohet. Kjo bënë që produktet që duhet të eliminohen nga veshkat akumulohen në gjakun e nënës, ndërkohë që proteinat e gjakut të humbasin përmes urinës. Me përparimin e sëmundjes, mëlçia e nënës, mushkëritë, truri dhe sistemi i koagulimit mund të preken gjithashtu. Komplikacionet më të rrezikshme të preeklampsisë janë konvulzionet (eklampsi), hemorragjia cerebrale (iktus),

edema pulmonare (likidi në mushkëri), insuficienca renale (bllokimi i funksionit të veshkave), insuficienca hepatike (bllokimi i funksionit të mëlçisë) dhe çregullimet në koagulim. Të gjitha janë të rrezikshme për jeten e nënës (9).

2.1.5 Çfarë mund të ndodh tek fetusi

Më reduktimin e fluksit të gjakut nga nëna te placenta, fetuesi merr më pak oksigjen dhe lëndë ushqyese. Kjo sjell fillimisht një ngadalësim të rritjes në peshë (IUGR) dhe më vonë edhe mungesë të oksigjenit. Në momentin që preeklampsia dyshohet, fetuesi duhet te monitorizohet me kujdes po aq sa nëna. Në rastet kur rritja ndalon ose kur gjendja e fetuesit është në rrezik, atëherë programohet lindja e fetuesit. Ky vendim është shumë më i lehtë për shtatëzënit që kanë kaluar javën e 30-të. Për shtatëzënitë më të vogla se 30 javë, asgjë e sigurtë nuk mund të thuhet për mbijetesën e fetuesit. Edhe mbi 30 javë, fetuesi mund të jetë në rrezik, por nga ana statistikore vdekshmëria dhe sëmundshmëria është më e vogël se sa kur shtatëzënia ndërpritet për shkak të preeklampsisë para javës së 30-të (9).

2.1.6 Faktorët predispozues të preeklampsisë

Janë identifikuar disa faktorë predispozues që rrisin rrezikun për preeklampsi:

- Situata në të cilën gruaja nuk ka lindur ose nuk ka qenë shtatëzënë më parë,
- Preeklampsi në familje,
- Obeziteti,
- Shtatëzëni me shumë fetuse,
- Preeklampsia në shtatëzëni të mëparshme,
- Përfundimi i dobët në shtatëzëni të mëparshme,
- Kufizimi i rritjes intrauterine, distako e placentës, vdekje të fetuseve (17) .

2.1.7 Menaxhimi i preeklampsisë

Preeklampsia nuk ka mjekim specifik. Është kjo arsyeja që sot studimet e mëdha përqendrohen tek parandalimi. Trajtimi përfundimtar i preeklampsisë është lindja e fëmijës për të parandaluar komplikacionet që bëhen shkak për vdekshmëri fetale dhe amtare. Zakonisht rekomandohet hospitalizimi me qëllim që të gjykojmë dhe të shmangim riskun e konvulsioneve, si dhe të vlerësojmë mundësit e mbijetesës së fetusit.

Preeklampsia i vë nënën dhe fetusin në rrezik. Sidoqoftë, është një çrregullim i nënës. Shtylla kryesore e trajtimit është zbulimi i hershëm dhe shpërndarja e menaxhuar për të minimizuar rreziqet e nënës dhe fetusit. Nëse shtatëzënia është në fund, vendimi është i lehtë; foshnja duhet të lindë. Vendimi për të ofruar ndihme, përfshin balancimin e rreziqeve të përkeqësimit të preeklampsisë kundrejt atyre të lindjes së parakohshme. Lindja në përgjithësi nuk indikohet për gratë me preeklampsi të butë deri në 37 deri në 38 javë të shtatëzënisë dhe mund të ndodhë deri në 40 javë. Nëse është larg terminit, nëna duhet të pranohet për vlerësim. Shtatëzëna do të ketë nevojë për:

- Testet fillestare dhe laboratorike serike (numërimi i plotë i qelizave të gjakut, kreatinina, acidi urik, ALT, AST),
